



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GRAMSH  
NJËSIA E PROKURIMIT

Gramsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

## PROCESVERBAL

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR E THJESHTUAR – MALLRA”**

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Blerje goma per automjetet”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** goma per automjetet e renda/te lehta -34350000-5

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

**1,876,500 (nje milion e tetëqindë e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqindë) lek pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gramsh** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit ,sipas Shtojcës 8*
- b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

##### **2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe shtojcës 8 të DST.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** të vlerës së përllogaritur të kontratës.

**Argumentimi:** Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 40, neni 43 dhe neni 55 pika 4, të V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, V.K.M Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: .... 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar ...". Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

**2.2.2** Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2021, 2022, dhe 2023**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

**2.2.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin e **maturuar** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKB, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 4, neni 55, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

**2.4.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryej shërbimin e transportit në adresat e përcaktuara nga AK.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresat e përcaktuara të AK-ve.

**2.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 1 (një) mjet transporti me peshë mbajtëse mbi 3.5 ton të përshtatshëm për transport mallrash. Mjetet e transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë në pronësi, të disponohet dokumenti certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit, dhe çertifikate për transportë mallrash brenda vendit.
- b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira, të disponohet kontrata e qirasë, dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, si dhe polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit dhe çertifikate për transportë mallrash për të tretë dhe me qera brenda vëndit.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të pika 5/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion 1 mjete për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Mjeti i mësipërm është i domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj I shërben Autoritetit Kontraktor për tu njohur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Duke qënë se kjo procedurë prokurimi ka në përbërjen e saj përvec mallrave edhe transportimin dhe instalimin e disa prej tyre e bën të domosdoshëm kërkesën për disponimin nga ana e ofertuesve të mundshëm ekonomikë edhe të mjeteve të nevojshme për realizimin në kohën e duhur të lëvrimit të tyre pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor.

**2.6. Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar, si me poshtë:**

Staffi	Nr.
Shofer	1
Punetore të thjeshtë	1
<b>Total</b>	<b>2</b>

- Për punonjesin e punësuar shofer të paraqitet kontrate pune perkatese si dhe leje drejtimi
- Për punonjesit e punësuar punetore të thjeshtë të paraqitet vetem kontrate pune perkatese.
- Operatori ekonomik të paraqes deklarate në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punë

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në objektin e prokurimit dhe

sasisë që kërkohet. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, numri i punonjësve të kërkuar, në bazë të kërkesës së Autoritetit Kontraktor, për realizimin e objektit.

**2.7** Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën **1 vjeçare** të garancisë së mallrave që kërkohen të prokurohen, në shfrytëzim normal sipas kushteve teknike të shfrytëzimit, nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi. Operatori ekonomik i shpallur fitues gjatë periudhës së garancisë është i detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit osë cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre.

**2.8.** Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi/ me qira ose kontratë bashkëpunimi 1 pikë servisi (gomisteri) brenda juridiksionit të Bashkisë Gramsh e cila do të shërbejë për heqjen e gomave të vjetra, vendosjen e gomave të reja, peshimin dhe kovergjencën.

- Në rast të disponimit të pikës së servisit (gomisterisë) në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e tij
- Ndërsa për pikën e servisit të marrë me qira/kontratë bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/ bashkëpunimit.

**Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur me anë të një deklaratë ku operatori ekonomik deklaron se në rast të shpalljes fitues merr përsipër ndërrimin e gomave dhe do të dorëzojë dokumentacionin e sipërcituar për pronësinë/qiranë ose kontratë bashkëpunimi për 1 pikë servisi (gomisteri)**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të pikës 4 dhe 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është vendosur për të shmangur kostot shtesë të autoritetit kontraktor si (karburant, kohë, burime njerëzore etj) si dhe për arsye të mungesës së pajisjeve dhe mjeteve që nevojiten për ndërrimin e gomave dhe për të krijuar besueshmëri tek operatorët ekonomik që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi për shkak të vlerës të lartë të mallrave që do të prokurohen.

Prandaj, kriteri i distancës kërkohet për shkak të specifikës së objektit të prokurimit pasi kontraktimi me një pikë servisi më të largët nuk do të ishte eficient për AK, dhe nuk do të arrihej në kohë.

**2.10.** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e

Përgjithshme e Akredimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijnë objektin e prokurimit:

- **ISO 9001- 2015** ose ekuivalente (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36, nenit 77, nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë dhe mjedisit e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin e shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të Autoritetit Kontraktor dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Autoritetit Kontraktor. Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

2.11.Operatori ekonomik duhet të paraqesë për zërin goma, katalog/pjesë katalogu të prodhuesit ose skeda teknike ku të pasqyrohen karakteristikat teknike të këtyre mallrave, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi pa TVSH	Vlera
<b>I</b>	<b>Kamioni Mercedes Benc DR 0846 D</b>				
1	Goma N215/75 R17.5 (F/V)	cope	5		
<b>II</b>	<b>Automjeti 904 Mercedes -Benz, Targ AA572 Tz, Nr Shasie WDB9046221R72</b>				
1	Goma 195/70 R 15 S (F/V)	cope	5		
<b>III</b>	<b>Mjeti Land- Rover "Defender" me targe GR 1520 B</b>				
1	Goma me llojka me nr 265/70 R16 (F/V)	cope	5		
<b>IV</b>	<b>Mjeti motor ZONGSHEN me targe GR 024 A</b>				
1	Goma para nr 21 dimerore (F/V)	cope	2		
2	Goma mbrapapara nr 18 dimerore (F/V)	cope	2		
<b>V</b>	<b>Benz Daimler Chrysler E250CDI, vit prodhimi 2010, nr. shasie WDD2120031A031252 me targe AA525TB</b>				
1	Goma 17 245/45 (F/V)	cope	5		
<b>VI</b>	<b>Landrover DISCOVER TD5 nr.shasie SALLTGM883A788197 me targe AA769GP</b>				
1	Goma 245/75 R16 (F/V)	cope	5		
<b>VII</b>	<b>Benz 203, vit prodhimi 2002 nr. shasie WDB2030061A383237me targe AA290EL</b>				
1	Goma NA 205/55/16 (F/V)	cope	5		
<b>VIII</b>	<b>Nisan patrol me targë AA023ZM viti i prodhimit 1998, me nr.shasie JN1WRGY60Z0253030</b>				
1	Goma 31*10.5 R15 LT (F/V)	cope	5		
<b>IX</b>	<b>Tip Kamion MAN, Targe AA 573 TZ: viti prodhimi 2001 nr.shasie WMAE72ZZZ1L04565</b>				

1	Goma 425/65 R 22.5 (F/V)	cope	2		
2	Goma 13/22.5 (F/V)	cope	5		
X	<b>Kamion Mercedes Benz, Targa AA603 ST, Nr Shasie WDB6593331550338, vit prodhimi 1990</b>				
	Goma 13 R 22.5 (F/V)	cope	4		
XI	<b>Kamion MAN Targa AA335AR, Nr Shasie WMAF104164M1956670, Vit Prodhimi 1995</b>				
1	Goma 315/80/22.5 (F/V)	cope	8		
XII	<b>Fiat-Hitachi, Tip 470 , nr shasie 470575, automatike,Targë AA451 ZT Vit prodhimi 2000</b>				
1	Goma 20.5 R 25 (F/V)	cope	2		
XIII	<b>Fuoristrad Mitsubish, Targe AA162 JM, nr shasie MMBJNK7405D0900190, Vit prodhimi 2004</b>				
1	Goma 245/70/16 (F/V)	cope	5		
XIV	<b>Rimorkiator AFR-497, Nr Shasie ZA9R30CDE10A13574, Viti i prodhimit</b>				
1	Goma 245/70 R 19 S (F/V)	cope	4		
	<b>Automjetet e zjarrefikeses</b>				
1	Goma 215/ 75 R 16 (F/V)	cope	5		
1	Goma 235/ 85 R 16 (F/V)	cope	1		
XV	<b>Autobusi Mercedes Benz nr shasie WDB9066571S257494, 515 CDI SPRINTER, targa AB179 LD, vit prodhimi 2008</b>		(F/V)		
1	Goma 205/75 R 16 C F/V	cope	7		




## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Në bazë të Urdhërit të Kryetarit nr 49. Datë 07.02.2024, për ngritjen e “Komisionit për përcaktimin e sasive, hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit Limit”, me objekt prokurimi “Blerje goma për automjetet” më poshte komisioni ka renditur specifikimet e duhura teknike për gomat që do të tenderohen.

1. Gomat duhet të jenë sipas kërkesave të përcaktuara në preventiv sipas llojit dhe numrit të përcaktuar.
2. Gomat duhet të jenë të reja, **nuk** duhet të jenë të riveshura.
3. Në sipërfaqet anësore, çdo gomë duhet të ketë të stampuar këto të dhëna:



4. Tipi i gomave (Tubeless TL / Tube Type TT)



- **P:** Për automjetet e pasagjerëve
- **LT:** Për kamionët
- **T:** Për përdorim të përkohshëm (Goma rezervë)

5. Gjerësia e gomës në mm.
6. Përfaqëson lartësinë e gomës e cila është për qindja e gjerësisë.
7. Konstruksioni Radial nga qendra e gomës.
8. Diametri i brendshëm i gomës në Inch.

9. \* (Jo e detyrueshme) Mbingarkesa (XL). Mbishkrimi XL pas diametrit të gomës do të thotë një gomë të përforcuar me një kapacitet më të lartë të ngarkesës sesa një gomë standarde me të njëjtën madhësi.
10. Kapaciteti mbajtës i gomës, limiti maksimal.
11. Shpejtësia maksimale për gomë me ngarkesë të plotë.
12. Simbolet M dhe S (M + S). Një gomë me shkronja "M" dhe "S" tregon një gomë të besueshme në kushte balte dhe bore pasi plotëson kërkesat e Shoqatës së Prodhuesve të Gomës.
13. Homologimi Evropian (E.), goma të jetë në përputhje me standardet e bashkimit evropian.
14. \* (Jo e detyrueshme) Goma e përforcuar "RF" në anën e gomës tregon se është forcuar për të përballuar një ngarkesë më të lartë.
15. Kodi i Sigurisë (Departamenti i transportit ose DOT). Mbishkrimi DOT në goma siguron përputhjen me standardet e sigurisë të Departamentit të Transportit Amerikan.
16. Data e Prodhimit. Në këtë kod, katër shifrat e fundit duhet të korrespondojnë me datën e fabrikimit të gomave (muajin) dhe (vitin).
17. UTQG Ky seksion paraqet klasifikimin uniform të cilësisë së gomave. Vlerësimi UTQG (Udhëzuesi Universal i Cilësisë së Gomës) bazohet në tre kriterë:
  - Tipari i parë i vlerësuar nga UTQG është jeta e një gome. Në veshjen e batisdradës, sa më i madh numri, aq më e gjatë është jeta e gomës. Numri fillon nga 100.
  - Aderenca [(Treguesi i aderences paraqet aderencën e gomës në sipërfaqe të lagështa. Ajo përcaktohet nga shkronjat AA (treguesi më i mirë), A, B dhe C (rezultati më i ulët i mundshëm)],
  - Temperaturën [(Indeksi i temperaturës përcakton masën në të cilën krijohet ose shpërndahet nxehtësia nga një gomë. Ky indeks është rezultat i testeve në laborator, si dhe testet rrugore. Një gomë e nxehtë mund të shkaktojë degradimin në mënyrë të parregullt. Indeksi vlerësohet nga shkronjat A (indeksi më i mirë) B dhe C (minimumi i kërkuar)].
- a) Të jenë të prodhimit për përdorim për 4 stinë, me simbolet dhe shenjat përkatëse. Të kenë të stampuar datën e prodhimit të javës dhe vitit.
- b) Të jenë të prodhimit jo më herët se 12 muaj nga data e zhvillimit të tenderit.
- c) Gomat e një dimensionit të jenë të gjitha të të njëjtit tip prodhimi.

#### **Garancia:**

- Garancia e gomave të ofruara të jetë ajo e përcaktuar nga klasifikimi cilësor i gomës (UTQG), e evidentuar në faqen anësore të gomës, kjo e konvertuar në km.
- Gomat të cilat nga ana konstruktive nuk kanë të evidentuar në faqen anësore të tyre, klasifikimin cilësor (UTQG) duhet ta ofrojnë garancinë :
  - a) Goma në përdorim për Motoçikleta (M/C): jo më pak se 15000 km.
  - b) Goma në përdorim për Autovetura 2x4; 4x4 (SUV):brandet të cilat nuk kanë të evidentuar, në faqet anësore të tyre, klasifikimin cilësor (UTQG), garancia do jetë ajo e konvertuar sipas klasifikimit cilësor, kjo e evidentuar në tabelë dhe shprehur në km.
  - c) Goma në përdorim për automjetet Furgona; Kamjonçina: jo më pak se 60000 km.
  - d) Goma në përdorim për automjetet Kamjona të Lehtë; Kamjona; Autobuza;
  - e) Garancitë e gomave të jenë të çertifikuara me dokumentacion garancie, të lëshuar nga prodhuesi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni i ngritur me me Urdhërin e Zyrtarit te Autorizuar N/Kryetarit të Bashkisë nr.49, datë 07.02.2024 Ngritjen e Komisionit për përcaktimin e sasive, hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e Fondit Limit për objektin e prokurimit “Blerje goma për automjetet”.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

### **NJËSIA E PROKURIMIT**

**ANËTAR**

Erionilda MIRAKA

**ANËTAR**

Julian MUHA

**ZYRTARI I AUTORIZUAR  
N/KRYETARI I BASHKISË**

Tajar BICI

*Konceptoi: Njesia*

*Miratoi: T.Bici*

*Konfirmoi:*

*Dosja nr: \_\_\_\_\_*

*Afati i ruajtjes: \_\_\_\_\_*